



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВСКА  
KOMUNA E OBILIQI - ОПШТИНА ОБИЛИЦ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës Irlazna

Nr. -1-01  
Br.

Data 16.01.2023  
Datum

OBILIQ - OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 53, të Ligjit nr. 03 / L-040, nenit 62 të Statutit të Komunës, thërras:  
Mbledhjen e Komitetit për Komunitete për dt.20.01.2023, ( e premte ) në ora 10:00 me këtë:

## REND DITE

- 1.Arsyetimi për mungesë
- 2.Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 3.Shqyrtimi i raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022
- 4.Informatë nga ZKKK-ja lidhur me raportin vjetor të kësaj zyreje
- 5.Të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete

  
Faton Beka





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINE OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1-02  
Br.

Data 16.01.2023  
Datum

OBILIC-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq – Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për komunitete, të mbajtur me dt.21.12.2022 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal. **Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Avdyl Mustafa, Florije Jashari, Faton Beka, Haki Abazi, Biljana Spasic, Valbonë Beka, Sanela Mackic, Lulzim Preniqi dhe Predrag Micalovic  
**Të pranishmit tjerë:** Slavisa Jakovljevic, Nënkrjetar i Komunës për komunitete, Blerona Mehmeti Shabanaj, drejtoreshë e DSHMS-së, të qëndrueshëm, Rukije Krasniqi, përf. nga Qendra për Punë Sociale dhe Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun

Mbledhjen e udhëhoqi Faton Beka, kryesues i Komitetit për komunitete, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me refuzimin e disa rasteve të asistencës sociale për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023
5. Formimi i Komisionit për hartimin e Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022
6. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua unanimisht.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Pasi që në këtë pikë të rendit të ditës e kemi cekë për disa raste sociale, nëse dikush prej anëtarëve të Komitetit ka diçka me thënë mund ta marrë fjalën.

**Avdyl Mustafa** – Ne kemi kërkuar informata nga DSHMS-ja, lidhur me refuzimin e disa rasteve të ndihmave sociale për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo, ka të bëjë me rastet e kategorisë së dytë. Ne kemi punuar, kemi dalë në terren dhe kemi marrë informacione se disa raste vërtetë janë të rënda, njerëzit janë në gjendje të sëmurë. Ne i kemi këshilluar që të shkojnë në Prishtinë, në qendër ti parashtrojnë disa dokumente tjera. Këta kanë shkue në ambullantën e KEK-ut dhe atyre iu kanë lëshue dokumente se janë të aftë për punë. Unë nuk e fajësoj Qendrën për punë sociale, por thjeshtë që kjo të shqyrtohet dhe këtyre iu është rekomanduar që së paku të presin një vit, pastaj të aplikojnë që të rifitojnë ndihmën sociale. Thjesht ata kërkojnë informacione se si duhet të aplikojnë për të marrë ndihmën sociale. Përndryshe unë e çmoj punën e Qendrës për punë sociale dhe të gjithë punonjësve që

punojnë aty dhe me siguri se ata i kryejnë punët e veta si duhet, por udhëzimet vijnë nga qendra kryesore e Prishtinës rreth këtyre rasteve, rreth dokumentacionit të nevojshëm.

**Përf. e Qendrës për Punë sociale** – Ne punojmë me të gjitha komunitetet në Komunën e Obiliqit dhe nuk janë vetëm komunitetet që janë refuzuar, por edhe tjerët. Për shkak të pandemisë 2 vite, me radhë i kemi dërguar në Komision mjekësor dhe kemi punuar me dokumente aktuale. Ministria e punës na ka sugjerue që të gjitha lëndët të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e parë të dërgohen në Komision mjekësor, ku disa prej tyre janë edhe të refuzuara, do të thotë diagnoza nuk ka qenë adekuate sepse atje janë neurologu, kirurgu, internisti dhe ata i shikojnë këto diagnoza. Nëse është i paaftë për punë atëherë atij personi automatikisht i lejohet ndihma sociale, ndërsa nëse është i aftë me punue atëherë ai e ka të drejtën me punue. Prej kategorisë së dytë nëse, dikush është ankuar Komisioni është që delë në terren i verifikon rastet nëse, ka fëmijë nën moshën 5 vjet, dhe e ka gjendjen e rëndë ekonomike ai e ka të drejtën e ndihmës sociale. Kriteret janë nëse, ka veturë automatikisht përjashtohet nga ndihma sociale. Mendoj se nuk ka vend për shqetësim se dikujt iu ka bërë e padrejtë dhe nëse, dikush mendon se iu ka bërë e padrejtë ai e ka të drejtën e ankesës në Departament, i cili e shqyrton ankesën. Nëse, dikush ka ndonjë emër konkret ne i kemi listat, mund të adresohet te ne dhe ne do ta shqyrtojmë prapë atë kërkesë. Ne e kemi administratorin Slavisa Stojic, që e falenderojmë shumë i cili është shumë i përpikët dhe punon mirë në punën e vet.

**Haki Abazi** – Unë e kam vetën një rast konkret pasi kuptova për çka është refuzuar. Ky rast është me aftësi të kufizuara, që është nga komuniteti egjiptian në Plemetin z.Bajram Ramluka, të cilit qe 2 muaj iu ka ndalë ndihma sociale. Kjo familje është në gjendje shumë të rëndë ekonomike.

**Përf. e Qendrës për Punë Sociale** – Ekzistojnë raste kur rasti është i rëndë, por ka mungesë të dokumentacionit mjekësor. Lënda ka shkue për shqyrtim dhe atje, janë specialistët sepse shumica e rasteve po shkojnë në ambullantë të KEK-ut dhe po i përshkruajnë, për ato 3 raporte që i marrin atje ua marrin dikund 30 euro, për çdo raport nga 10 euro ua marrin, por diagnostikohen se çfare e ka nuk ia ka shkruajtë. Në këtë rast z.Bajrami duhet të shkon në Shtëpinë tonë të shëndetit, i merrë udhëzimet dhe adresohet në spital atje ku edhe kontrollohet. Pastaj ato diagnoza i sjellë prapë shkon në QKMF, e përshkruan në certifikatë të mjekut dhe atë certifikatë ne e dërgojmë në Komisionin mjekësor. Nëse, nuk ka diagnostikë atëherë Komisioni mjekësor e refuzon sepse duhet të jetë prej 70-80 % i paaftë, ose ai mund të shkoj të marrë një raport në konsullatë dhe të drejtohet në pension invalidor.

**Kryesuesi** – Duhet me kuptue se janë disa kriteret që duhet të plotësohen nga Ministria për punë dhe mirëqenie sociale, të cilët i verifikojnë. Pajtohem me parafolësen që tha se nëse, dikush mendon se iu ka bërë padrejtësi mund të ankohet dhe të shyrtohet rasti në fjalë.

**Slavisa Jakovljević** – Në bazë të fjalës së përf.të Qendrës për Punë sociale, nuk e dëgjova numrin e përgjithshëm të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në Komunën e Obiliqit.

**Përf. e Qendrës për Punë Sociale** – Në muajin e fundit e kemi numrin 653.

**Slavisa Jakovljević** – Faleminderit për informatën, por mund të them se është numri shumë i madh sepse për të marrë dikush ndihmë sociale duhet ti plotësoj disa kushte. Të gjithë ata që janë të aftë për të arritë të ardhurat e tyre, ata nuk mund të jenë shfrytëzues të ndihmës sociale. Unë nuk jam kundër shfrytëzuesve, por ne duhet të jemi real dhe nuk do të duhej të kemi një numër aq të madh të shfrytëzuesve të ndihmave sociale. Në fjalën tuaj e falënderuat kolegun tuaj që është shumë i mirë në punë dhe i kryen detyrat si duhet. Unë nuk do të ia përmend emrin, por them se ai nuk punon si duhet dhe mund të japi disa shembuj që në fakt ai nuk bën asgjë tjetër përveç se merrë dokumentacione, nuk vendos ai vetë se kush do të jetë shfrytëzues, apo jo shfrytëzues i ndihmës sociale. Ju, mund të ia përcillni të gjithëve, se nga pikëpamja ime ka shumë lëshime në Qendrën për Punë Sociale dhe nuk do ta kishim një numër kaq të madh të shfrytëzuesve të ndihmave sociale. Ju thatë se nëse, dikush ka veturë nuk e ka të drejtën e ndihmës sociale, që pajtohem plotësisht me juve. Po ashtu, pajtohem me juve kur thatë se nuk e shikojmë personin se nga cili komunitet vjen dhe këtu ju falënderoj që nuk bëni dallime. Unë ju them me siguri se nga 653 shfrytëzues të ndihmës sociale 50 % të njëjtit kanë veturë, kështu që do të doja që në Komunën e Obiliqit, të ketë shumë më pak shfrytëzues të ndihmave sociale sepse kjo nuk shkon në dobinë tonë. Unë nuk do të pajtohesha plotësisht me juve sepse kemi njerëz që nuk e realizojnë të drejtën e ndihmës sociale, prandaj kemi edhe raste që nuk marrin ndihma rastet e rënda. Prandaj, si Nënkryetar për komunitete ju lus, që ju të keni më shumë kujdes me njerëzit të cilët nuk realizojnë të ardhura.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Në mbledhjen e fundit të Komitetit për komunitete, e kemi formuar një Komision prej 5 anëtarëve për hartimin e planit të punës për vitin 2023. Ju njoftoj se me dt.7 dhjetor kemi mbajtur një takim ku të gjithë anëtarët e Komisionit ishin përveç Sanela Mackic, e cila për arsye të ndryshme ka munguar. Unë i falënderoj anëtarët e Komisionit për kontributin e tyre.

**Predrag Micalovic** – Pasi që unë kam qenë anëtar i Komisionit, jemi marrë vesh që sot të propozojmë se cila do të jetë dita e komunitetit serbë si festë për ta përfshirë në plan të punës, 21 shtatori do të jetë si ditë festive e komunitetit serbë, Dita e kishës.

**Kryesuesi** – Ne gjatë takimit i kemi përfshirë disa tryeza edhe ditët nacionale si ditën e ashkalive që është me 15 shkurt, ditën e komunitetit rom me 9 prill, ditën e komunitetit egjiptian me 24 qershor, ditën e komunitetit boshnjak me 28 shtator dhe jemi dakordue për ditën e komunitetit serbë tani me propozimin e z.Predrag Micalovic, me 21 shtator.

Të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete unanimisht e miratuan Planin e punës të Komitetit për komunitete për vitin 2023 me ndryshimet e cekura më lartë.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Meqë, jemi në fund të vitit duhet ta formojmë Komisionin për hartimin e raportit të punës të Komitetit për komunitete për vitin 2022. Unë propozoj të jenë 3 anëtarë, por ju vendosni.

**Haki Abazi** – Ne çdonjëri kemi obligime dhe pajtohemi që të jenë 3 anëtarë.

Të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete unanimisht u pajtuan që Komisioni ti ketë 3 anëtarë.

**Kryesuesi** – Propozoj z.Avdyl Mustafa, për arsye se ai ka qenë kryesues i Komitetit deri me 20 shtator të këtij viti dhe kishte me qenë mirë të jetë pjesë e këtij Komisioni.

**Haki Abazi** – Propozoj z.Predrag Micalovic, për anëtar të Komisionit.

**Kryesuesi** – Propozon znj.Biljana Spasic, për anëtare të Komisionit. Unë anëtar i Komisionit nuk do të jem, por do të jem vëzhgues.

Anëtarët e Komitetit për komunitete, e miratuan formimin e Komisionit për hartimin e raportit të punës së Komitetit për komunitete, për vitin 2022 me këtë përbërje: Avdyl Mustafa, Predrag Micalovic dhe Biljana Spasic.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Haki Abazi** – Unë kam një shqetësim që më janë adresue disa pjesëtarë të komunitetit egjiptian nga fshati Plemetin. Në kohën e fundit në Plemetin, janë paraqitë disa hajdutë që janë shqetësim për banorët. Unë deshta me paraqitë këtë çështje që me marrë pak më seriozisht edhe stacioni i policisë sepse 3 herë me shkue dhe me paraqitë rastin, e tretën herë me ia përmendë stacionin e Prishtinës për me marrë seriozisht rastin. Unë nuk po e shohë të arsyeshme që stacioni ynë policor të mos bëjë sa duhet, sepse ne e kemi stacionin tonë policor, por konkretisht duhet ti dërgojnë policët atje.

**Kryesuesi** – Nëse, ke rast specifik është mirë me thënë.

**Haki Abazi** – Është Afrim Krasniqi, nga komuniteti ashkali, të cilit iu janë vjedhë disa gjëra, por ka edhe raste të cilat nuk janë paraqitë. Prandaj, po i them kryesuesit që të diskutohet në Këshillin komunal për siguri në bashkësi, që të mos bëhet Meksikë fshati Plemetin.

**Kryesuesi** – Mua, më vjen keq dhe pajtohem me shqetësimin që e ngrite, por këto gjëra nuk ndodhin vetëm te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, do të thotë ndodhin në përgjithësi. Mirëpo, pasi që jam anëtar i Këshillit komunal për siguri në bashkësi në mbledhjen e radhës, do ta ngriti këtë shqetësim ku është prezentë aty edhe komandanti i stacionit policor dhe sigurisht se do të merren masa nga organet e rendit. Në mbledhjet e kaluara e kemi pasë një rekomandim nga z.Haki Abazi, lidhur me rregullimin e disa varrezave në fshatin Plemetin dhe në lagjen e Hashanëve. Ne ia kemi rekomanduar DSHPE-së, që me na dhënë informatë dhe në mbledhjen e kaluar ishte prezentë përfaqësuesi i DSHPE-së, z.Hamit Mjeku i cili na informoi se kanë fillue punimet atje për rregullimin e platove të varrezave. Po ashtu, ka qenë edhe një rekomandim nga z.Avdyl Mustafa, lidhur me trafon në Plemetin dhe kemi kërkuar nga DSHPE-ja, që të na informoj. Neve, na ka kthye një përgjigje me shkrim të cilën ua kemi dërgue juve, në email dhe sa mundemi me kuptue drejtori ka thënë se KEDS-i, në bashkëpunim është duke e stabilizue trafon, por e dijmë se gjendja e trafos nuk është e mirë dhe banorët kanë probleme. Mirëpo, shpresoj se KEDS-i, në

bashkëpunim me Komunën munden me rregullue këtë çështje. Në fund ju uroj festat e fundvitit me shpresë që të kemi një fillim të mbarë të punës në vitin 2023 dhe do të punojmë të gjithë bashkarisht për të mirën e të gjithëve.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:32'**

**Procesmbajtësja**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesi i Komitetit për komunitete**

  
Faton Beqa

